

AKT THEMELIMI I SHOQËRISË TREGTARE

“DREAM TRAVEL & TOURS” sh.p.k

Tiranë, më datë 05/12/2024

NENI 1

Shoqëria Tregtare “DREAM TRAVEL & TOURS” sh.p.k (në vazhdim Shoqëria) formohet si shoqëri tregtare sipas ligjit 9901 e datës 14/04/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” të ndryshuar dhe do të funksionojë në bazë të këtij akti themelimi dhe statutit të miratuar prej saj.


NENI 2 - EMRI I SHOQËRISË

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin “DREAM TRAVEL & TOURS” sh.p.k.

NENI 3 - OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Shoqëria do të ketë si objekt ushtrimin e të gjitha veprimtarive të mëposhtme:

- Ushtrim i veprimtarisë së lire private në fushën e turizmit në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- Organizim i grupeve të ndryshme turistike vendas dhe të huaj dhe kryerja e guidave turistike me ta brenda dhe jashtë vendit;
- Akomodimi i grupeve të ndryshme turistike në hotele, fshatra turistike, kampingje, shtëpi pushimi, restorante, etj.
- Shoqërim me/pa perkthyes dhe me/pa cicerone i grupeve të ndryshme turistike në guidat e tyre brenda dhe jashtë vendit;
- Agjensi për shitjen e biletave të udhëtimit për mjetet e transportit ajror, detar, hekurudhor dhe tokësor sipas marrëveshjeve të bëra me persona të ndryshëm fizikë dhe juridikë vendas dhe të huaj në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- Organizim dhe kryerje e shërbimit të ndërmjetësimit, të përfaqësimit dhe të komisionerisë me persona fizikë dhe juridikë vendas dhe të huaj për kryerjen e veprimtarive të ndryshme turistike;
- Organizimi dhe kryerja e propagandas dhe reklames turistike me mjetet e ndryshme të informacionit të lejuar;



- Organizim dhe kryerje e veprimtarive te ndryshme me turistë vendas dhe te huaj, si: hipizem, motociklizem, gara makinash, bicikletash, etj.
- Organizim dhe kryerje e transportimit te turistëve vendas dhe te huaj me mjete te ndryshme te transportit ajror, detar, hekurudhor dhe tokesor shteteror apo privat, te vet shoqërisë apo te marra me qira (renta car) ne te gjithë territorin e Republikës se Shqipërisë dhe jashte saj, ne perputhje me legjislacionin e lejuar.
- Aplikim vizash. - Marketing Online. - Sherbim Pagesash. – Siguracione. - Shitje - Blerje mallrat e ndryshem.

NENI 4 - SELIA E SHOQËRISË

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit" , Twin Towers, Tower B, kati 5, pranë BLC, Tiranë.

NENI 5 - KAPITALI I SHOQËRISË


Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë i përbërë nga kontributi i ortakëve themelues të kësaj Shoqërie, në para në vlerën 100.000 Lek. Kapitali ndahet në dy (2) pjesë dhe pronësia e kuotave nga ortakët e shoqërisë vijon si më poshtë:

1. Ilir Qafa, lindur në Berat, më 09/06/1978, shtetas Shqiptar, mbajtës i letërnjoftimit me nr. 033276346, zotëron 50% të shoqërisë, e barabartë me një pjesë, me një vlerë të përgjithshme prej (50.000) lekë.
2. Armir Jangulli, lindur në Godvi, Bulqizë më 12.09.1996, shtetas shqiptar, mbajtës i letërnjoftimit me nr.038961234 zotëron 50% të shoqërisë, e barabartë me një pjesë, me një vlerë të përgjithshme prej (50.000) lekë.

Kapitali themeltar është investuar nga ortakët themelues në total. Vlerësimi dhe pagesa e kapitalit themeltar është kryer nga Ortakët Themelues.

NENI 6 - KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar. Afati i veprimtarisë fillon mbas regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar.

NENI 7 - ORGANET DREJTUESE

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve – organi më i lartë vendimmarrës;
2. Administratori – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

Mënyra e organizimit të tyre dhe funksionimit është e përcaktuar në Statutin e Shoqërisë. Shoqëria do të administrohet nga Administratori, i cili zgjidhet për një afat pesë vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje.

Administratori i parë i Shoqërisë është Armir Jangulli, shtetas Shqiptar, i Lindur në Bulqizë, më 12.09.1996, me nr. personal J60912011C, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me një afat emërimi prej 5 (pese) vitesh, afat ky fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit. Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratori, i cili i ushtron këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

NENI 8

Ekspertët kontabël të autorizuar të Shoqërisë do të emërohen në përputhje me ligjin në fuqi dhe për çdo vit financiar vjetor për veprimtarinë e shoqërisë. Shoqëria do të emërojë ekspertin kontabël.

NENI 9


Ortakët themelues mund të vendosin me vullnetin e tyre, për pjesëmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojnë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

NENI 10

Organizimi dhe funksionimi i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

NENI 11

Ortakët detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë



Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

NENI 12 - ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE


Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis ortakëve apo midis ortakëve dhe Shoqërisë dhe të cilët mund të kenë si objekt të drejta si rrjedhim i raporteve të tyre me shoqërinë do të zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

NENI 13 - DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Akt i Themelimit hartohet në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe.


ORTAKU

Ilir Qafa


(emer, mbiemer, firme)

ORTAKU

Armir Jangulli


(emer, mbiemer, firme)